


## СË BASHKU NËPËRMJET LIDHJES REGIONALE, DERI TE KRIJIMI I STABILITETIT NË RAJON NË KUSHTE TË SFIDAVE EKONOMIKE

Drejtoresha e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Sanja Llukarevska mori pjesë në Samitin e ministrave për financa, guvernatorë dhe drejtorë të administratave tatimore nga Sllovenia, Kroacia, Mali I Zi, Sërbia, Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, i cili tradicionalisht çdo vit mbahet në Beçiqi në Mal të Zi.

Tema e Samitit ti sivjetshëm është **“Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon në kushte të shprehura me rreziqe gjeo-politike”**

Samitin e hapi kryetari i Shoqatës së Ekonomistëve të Sërbisë, Aleksandar Vllahoviç, i cili theksoi se është me rëndësi të veçantë të ketë shkëmbim të mendimeve ndërmjet shteteve të rajonit dhe konceptim të përbashkët të politikës fiskale dhe monetare në periudhë të sfidave gjeo-politike dhe ekonomike.



Kjo, siç theksuan pjesëmarrësit e Samitit është shumë me rëndësi, për shkak se ekonomitë e Ballkanit janë të lidhura mes vete dhe është e nevojshme të krijohen kushte dhe të parashihen masat se si pa bariera të mëdha të vazhdohet për t'u thelluar bashkëpunimi i ndërsjellë.

Drejtoresha Llukarevska në paraqitjen e saj theksoi se ekonomitë e Ballkanit janë të lidhur ngusht mes vete dhe thellimi i bashkëpunimit është i mirëseradhur për të gjitha vendet e rajonit. “Si administratë tatimore në këtë moment kemi një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në sigurimin e bazës për stabilitet të financave publike të vendeve tona.

Për shkak të kushteve specifike në të cilat gjendemi, qëndrojmë stoik para sfidës së madhe, të sjellim politika dhe reforma konzistente. Investojmë në administratë tatimore bashkëkohore dhe me përkushtim bashkëpunojmë dhe i avancojmë bashkëpunimet me administratat tatimore të rajonit” theksoi drejtoresha Llukarevska.



Në konferencën, përveç ministrave të financës, guvernatorët dhe drejtorët e administratave tatimore, pjesëmarrës ishin edhe shumë ekspertë nga Sërbia, Mali I Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, BH, Kroacia dhe Sllovenia, si dhe përfaqësues të Bankës Evropiane për Investime EIB, FMN, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve dhe kompanitë më të mëdha të rajonit. Samiti i ministrave për financa, guvernatorë dhe drejtorë të administratave tatimore mbahet për të nëntën herë me radhë.